



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË  
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ELVIRA G. ALIBALI  
ADRESA NR.7, BLV"GJERGJ  
FISHTA", KATI I PARE, NR. 6/1  
TEL: 682035257

# KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 1166

  
Tirane më 10/05/2021

Nr. koleksioni: 300

2

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021052460031680434



Zos Dlek



A2021052460031680434

## KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

( TË SHOQËRISË "ALBAMEDIA SH.P.K)

Sot, më datë 10/05/2021, e hene para meje Notere ELVIRA G. ALIBALI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, NR.7, BLV"GJERGJ FISHTA", KATI I PARE, NR. 6/1, u paraqit personalisht:

### SHITES:

Shpëtim Dulaj, atësia Brahim, amësia Bukurije, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Mujo Ulqinaku; Nd. 52; H. 8; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 24/03/1973, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 034600015 dhe nr. personal H30324062N, .

*Nga çertifikata e përbërjes familjare e gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile) në dt. 06/05/2021 rezulton se shtetasi Shpëtim Dulaj është i martuar me shtetasin **Suela Dulaj**. Për shkak të fitimit të të drejtave të pronësisë përgjatë martesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Familjes, Ipso jure, si bashkëpronarë është edhe bashkëshortja e tij.*

Suela Dulaj, atësia Hamdi, amësia Suzana, shtetase Shqiptare, lindur në Tiranë dhe banuese në Tiranë, me adresë Mujo Ulqinaku; Nd. 52; H. 8; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 01/06/1974, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 034642132 dhe nr. personal H45601257Q, .

### BLERES:

Dritan Xhaferi, atësia Caf, amësia Semiha, shtetas Shqiptar, lindur në Shkodër dhe banues në Tiranë, me adresë Durrësit; Nd. 228; H. 1; Ap. 15; Njësia Administrative Nr. 10; Njesia Bashkiake Nr. 10; 1001; Tiranë, lindur më 11/04/1972, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035681956 dhe nr. personal H20411110U, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë "ALBAMEDIA" Sh.p.k., sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

**Baza Ligjore :** Dispozitat e Kodit Civil , Neni 705 e vijues i tij  
Neni 74 i Kodit të Familjes  
Ligji 9901 dt. 14.04.2008 « Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare » i ndryshuar .  
Ligji 9723 dt. 03.05.2007 « Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit » i ndryshuar



A2021052460031680434

### Kushtet paraprake

A) Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "Albamedia" Sh.p.k. është rregjistruar si person juridik ne Q.K.R me Nipt. **K46811001V**, me Seli ne Adresën: SHKODER Lagjia Naim Gjylbegu, Bulevardi Bujar Bishanaku, zona kadastrale 8592, nr pasurise 3/724; me kapital themeltar 9.400.000 leke, me ortakë: Shpetim Dulaj- 1,00 pjesë të barabartë me 49,00 % në vlerën 4.606.000 lekë; Dritan Xhaferi - 1,00 pjesë të barabartë me 51,00 % e barabratë me 4.794.000 lekë; administrator i shoqërisë është Dritan Xhaferi.

B) Sipas konfirmimit të marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, rezulton se mbi kuotën e pjesmarrjes në këtë kompani të ortakut/shitësit Shpetim Dulaj është vendosur barrë siguruese:

- Numri i ceshtjes: CN-600048-12-17 Arsytet e hapjes se ceshtjes: Depozitimi i marreveshjes siguruese mbi kuotat e pjesemarrjes ne shoqeri, Nr. 5441 Rep., Nr. 1832Kol., date 16.12.2017 midis "Raiffeisen Bank" sh.a (barremares/kredidhenes), Shpëtim Dulaj dhe Dritan Xhaferi (barredhenes) dhe shoqerise "ALBAMEDIA" sh.p.k, (kredimarres).

C. Shitësi, ka vendosur të shesë **kuotën e tij që disponon në kapitalin themeltar të Shoqërisë** dhe Blerësi është i detyruar të paguajë për to shumën e rënë dakort sipas kushteve dhe termave të kësaj Kontrate.

D) Bazuar në Deklaratën Noteriale Nr. 2533 Rep, Nr. 773 Kol, dt. 10/05/2021 vërtetuar nga notere Ardjana Mediu, deklaruesi Banka "Raiffeisen Bank" sha, nëpërmjet përfaqësuesve të saj ka deklaruar se:

**"Japim miratimin për të lejuar kalimin e pronësisë se kuotave ne masen 49% (dyzete e nente perqind) te kapitalit te Shoqerise "ALBAMEDIA" sh.p.k, nga Shpetim Dulaj ne emrin e bleresit Dritan Xhaferi, e vendosura si barrë siguruese në favor të Bankës, me kushtin që ato të vazhdojnë të qëndrojnë të bllokuara edhe pas kalimit të pronësisë në emrin e pronarit të ri".**

Palët duke marrë parasysh sa më sipër, pranojnë të lidhin këtë Kontratë shit-blerje të kuotës (në vijim «Kontrata») sipas kushteve të mëposhtme :

### Neni 1. Çmimi i kuotave dhe procedura e kryerjes së pagesës

1.1 Nëpërmjet kësaj Kontrate **Shitësi Shpetim Dulaj** merr përsipër të shesë dhe transferojë tek Blerësi **Dritan Xhaferi** 1 kuotë/pjesë të tij të barabartë me 49,00 perqind të kapitalit, kundrejt **çmimit 4.606.000 ( katëmilion e gjashtëqind e gjashtëmijë) lekë.**

1.2 Blerësi **Dritan Xhaferi** pranon të blejë nga Shitësi **Shpetim Dulaj** 1 kuotë/pjesë të barabartë me 49,00 perqind të kapitalit kundrejt **çmimit 4.606.000 (katëmilion e gjashtëqind e gjashtëmijë) lekë.**

1.3 Palet deklarojnë se çmimi i shitjes prej **4.606.000 ( katëmilion e gjashtëqind e gjashtëmijë) lekë do të likujdohet nga ana e blerësit brenda 3 muajve nga data e nënshkrimit të kontratës.**

1.4 Me nënshkrimin e kontratës kalon menjëherë pronësia nga shitësi **Shpetim Dulaj** tek blerësi **Dritan Xhaferi** duke u bërë tashmë shoqëria " Albamedia " Sh.p.k shpk vetëm me një ortak:

- Dritan Xhaferi zotërues i **1 kuote/pjesë**, të barabartë me 100,00 përqind të kapitalit me vlerë 9.400.000 ( nëntëmilion e katërqind mijë) lekë, por duke ngelur detyrimi për shlyerjen e cmimit të shitjes brenda 3 muajve nga ana e blerësit.



A2021052460031680434

1.5. Palët vendosin si kusht që në momentin e likujdimit përfundimtar dhe të plotë të cmimit të shitjes nga ana e blerësit, shitësi duhet detyrimisht të lëshojë një deklaratë noteriale ku të konfirmohet kjo shlyerje.

1.6 Në rast të mospërbushjes së detyrimit të likujdimit të cmimit të shitjes sipas afatit të përcaktuar në nenin 1.3, shitësit i lind menjëherë e drejta të kërkojë përmbushjen e detyrimit gjyqesisht.

## Neni 2. Deklarime dhe Garancitë e Shitësit

2.1 Shitësi deklaron dhe garanton se është e vetmi pronarë dhe titullarë të ligjshëm të kuotave dhe i të drejtave që rrjedhin prej tyre.

2.2 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria është themeluar dhe operon rregullisht në bazë të legjislacionit shqiptar dhe në bazë të akteve të shoqërisë, ka të drejtë të plotë për të ushtruar aktivitetin e saj në përputhje me aktin e themelimit dhe statutin që rregullon funksionimin e saj.

2.4 Shitësi deklaron dhe garanton se Shoqëria nuk është në proces falimentimi, likujdimi të vullnetshëm ose jo apo në ndonjë proces të ngjashëm.

## Neni 3. Garancitë e Blerësit

3.1 Blerësi deklaron se e njeh statusin faktik dhe ligjor të Shoqërisë.

3.2 Blerësi deklaron se është në dijeni të faktit se kuotat e shitësit Shpëtim Dulaj janë të bllokuara nga Banka, dhe është dakort që ti blejë ato në statusin juridik që ato ndodhen, **dhe me kalimin e pronësisë në emrin e tij, ato të vazhdojnë të mbesin të bllokuara për llogari të bankës.**

3.2 Blerësi e nënshkruan rregullisht këtë kontratë e cila është e vlefshme, e ligjshme dhe e detyrueshme për zbatim nga ana e Blerësit.

3.3 Blerësi ka kryer të gjitha veprimet, ka marrë të gjitha masat për përmbushjen e të gjitha detyrimeve sipas kësaj kontrate.

3.4 Administratori Dritan Xhaferi do të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të paraqitur këtë kontratë në QKB, me qëllim regjistrimin e ndryshimeve respektive .

## Neni 4 Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

4.1 Palët angazhohen të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrveshje që lidhet me interpretimin dhe ekzekutimin e kësaj Kontrate.

4.2 Nëse nuk arrihet një zgjidhje me mirëkuptim, mosmarrveshja do të zgjidhet ekskluzivisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## Neni 5 E drejta e zbatueshme

5.1 Kjo kontratë dhe të drejtat e detyrimit e Palëve do të disiplinohen dhe ushtrohen në bazë të së drejtës shqiptare.

## Neni 6 Vlefshmëria

6.1 Kjo kontratë është e vlefshme me nënshkrimin e saj nga palët.

6.2 Kontrata hartohet në 3(tre) origjinalë.



A2021052460031680434

6.3 Palët pasi e pranuan sa është shkruar në Kontratë, e nënshkruan si më poshtë rezulton, një nga të cilat për ta paraqitur në QKB për të bërë të mundur rregjistrimin e ndryshimeve përkatëse, një për Shitësin, një kopje për Blerësin.

**Palët**

**Shitësi**

**Shpëtim Dulaj**

**Jep pëlqimin bashkëshortja e tij  
Suela Dulaj**

**Blerësi**

**Dritan Xhaferi**



**Notere**






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Bashkia Tiranë

Njësia administrative Njësia Administrative Nr. 10

Zyra e Gjendjes Civile 382



Datë: 10.05.2021

### CERTIFIKATË FAMILJARE

Në bazë të Regjistrit Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010, vërtetohen të dhënat e mëposhtme:

Nr.	Emri e Mbiemri	Emri i Babait	Emri i Nënës	Gjinia	Lidhja me K. Familjarin	K. Datëlindja	Gjendja Civile	Vendlindja	Shtetësia	Numri Personal
1.	Shpëtim Dulaj	Brahim	Bukurije	M	Kryefamiljari	24-03-1973	i/e martuar	Shkodër	Shqiptare	H30324062N
2.	Suela Dulaj	Hamdi	Suzana	F	Bashkëshortja	01-06-1974	i/e martuar	Tiranë	Shqiptare	H45601257Q
3.	Jona Dulaj	Shpëtim	Suela	F	E bija	05-05-2001	Beqar	Tiranë	Shqiptare	K15505061T
4.	Drini Dulaj	Shpëtim	Suela	M	I biri	17-09-2007	Beqar	Tiranë	Shqiptare	K70917068F
5.										
6.										
7.										
8.										
9.										
10.										

Kjo certifikatë lëshohet për

Dokument

Nëpunësi i Gjendjes Civile

(Emri, Mbiemri, Nënshkrimi, Vula)



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria e  
Përgjithshme e Gjendjes Civile  
Date: 2021/05/10 10:58:45 +02:00  
H30324062N2021051010583743F001

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile)

LETËRNJOFTIMI ID REPUBLIKA E SHQIPËRISE REPUBLIC OF ALBANIA



emri/emri/first name  
**Xhaferi**  
emri/emri/last name  
**Dritan**  
shtetësia/nationality  
**Shqiptare/Albanian**  
vendndëshja/place of birth  
**Shkodër - ALB**  
deshtina/date of birth  
**11-04-1972**  
data e lëshimit/date of issue  
**27-01-2020**  
autoriteti /ishues/authority  
**MPB**



nr. letërnjoftimi/card no.  
**035681956**  
gjinia/sex  
**M**  
data e skadimit/date of expiry  
**26-01-2030**  
nr. personal/personal no.  
**H20411110U**